

LIGJ
Nr.8288, datë 18.2.1998

PËR ENTIN RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Objekti i ligjit është ngritja e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve (ERT). Në këtë ligj përcaktohen funksionet, kompetencat dhe procedurat, në bazë të të cilave ky ent do të punojë.

Objektiv i rëndësishëm i këtij ligji është garantimi dhe mbrojtja e interesave publikë dhe krijimi i një mjedisi transparent ligjor e rregullator që do të nxitë investimet private në këtë sektor.

Neni 2
Përkufizime

1. “Enti Rregullator i Telekomunikacioneve” është institucion i rregullimit të sektorit të telekomunikacioneve (ERT).
2. “Këshill” do të kuptohet Këshilli Drejtues i ERT.
3. “Ministri” është ministria që mbulon telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë.
4. “Shërbime të telekomunikacioneve” janë veprimtari tregtare të transferimit të informacioneve nga një burim drejt një ose me shumë destinacioneve.
5. “Interkoneksion” është lidhja midis rrjeteve të operatorëve të ndryshëm.
6. “Operator” është çdo person fizik apo juridik, i cili i ofron publikut shërbime telekomunikacionesh.
7. “Operator i telekomunikacioneve për publikun” është çdo shoqëri tregtare, së cilës i është dhënë licencë për të shfrytëzuar një rrjet telekomunikacionesh për publikun dhe/ose të ofrojë shërbime të telekomunikacioneve për publikun.
8. “Operator i pavarur i telekomunikacioneve” është çdo shoqëri tregtare së cilës i është dhënë një licencë për të ngritur dhe/ose për të shfrytëzuar një rrjet të pavarur të telekomunikacioneve.
9. “Rrjeti i telekomunikacioneve” është ajo pjesë e rrjetit që mund të transmetojë çdo lloj sinjali dhe përbëhet vetëm nga tufat kryesore të multipleksuara të transmetimit dhe nyjat që sigurojnë lidhjen e tyre. Ai nuk lidhet drejtpërdrejt me pajtimtarët. Mund të jetë fibër optike, kabëll ose radiourë.

KREU II
KRIJIMI I ERT

Neni 3
Ngritja dhe përbërja e ERT

1. ERT është person juridik, publik, jobuxhetor me të gjitha të drejtat dhe detyrat sipas legjislacionit në fuqi. ERT drejtohet nga një këshill drejtues.
2. Këshilli përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët drejtojnë edhe sektorë përkatës të këtij enti. Ata

emërohen për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje, por jo më shumë se dy herë.

Një nga anëtarët e Këshillit emërohet nga Presidenti i Republikës, dy anëtarë emërohen nga Kuvendi Popullor dhe dy anëtarë emërohen nga Këshilli i Ministrave. Kryetari i Këshillit emërohet nga Këshilli i Ministrave.

Anëtarët e këshillit drejtues duhet të jenë specialistë të kualifikuar, me arsim të lartë, me të paktën 10 vjet përvojë pune në sektorin e telekomunikacioneve të ekonomisë, të drejtësisë dhe të administratës publike.

Çdo anëtar, para emërimit, do të njoftojë organin që e ka emëruar, se do të japë dorëheqjen nga çdo post, punësim a funksion konsulence, si dhe do të shesë dhe do të likuadojë çdo interes financiar që mund të ketë në favor të tij në çdo shoqëri, firmë, grup-personash apo kompani që ushtron veprimtari tregtare nën juridiksionin e ERT.

3. Një person nuk mund të jetë anëtarë i këshillit drejtues nëse:

a) është deputet i Kuvendit Popullor apo ka një post tjetër, si i zgjedhur a i emëruar në pushtetin lokal;

b) ka lidhje të afërta familjare me ata anëtarë të Këshillit të Ministrave, pozita e të cilëve mund të krijojë konflikt interesash për anëtarin e këshillit;

c) ka qenë i dënuar nga gjykata për vepra penale;

d) ka interesa financiare në një korporatë apo shoqëri që i nënshtrohet kuadrit rregullator të ERT;

e) është i përjashtuar me ligj nga mundësia për të mbajtur poste publike/shtetërore.

Neni 4

Lirimi dhe shkarkimi i anëtarëve të këshillit drejtues

1. Anëtari i këshillit drejtues shkarkohet apo lirohet nga organi që ka bërë emërimin kur:

a) personi është në pamundësi fizike ose mendore për të kryer funksionet e ngarkuara;

b) gjatë ushtrimit të detyrës është dënuar nga gjykata për një vepër penale, për të cilën ligji parashikon dënimin me burgim;

c) emërohet punonjës i administratës shtetërore apo zgjidhet deputet i Kuvendit Popullor ose në organet e pushtetit lokal, me përjashtim të anëtarësisë në shoqata profesionale a politike dhe në detyra që i përkasin këtyre të fundit;

d) pa ndonjë shkak të arsyeshëm, ka refuzuar të kryejë apo nuk kryen detyrën ose është i paaftë për të ushtruar detyrën për një periudhë prej 6 muajsh a më tepër;

e) përfshihet në ndonjë nga dispozitat e nenit 3 të këtij ligji.

2. Kur një anëtar shkarkohet apo lirohet nga detyra, siç parashikohet në pikën 1 të këtij neni, anëtari i ri të emërohet nga organi sipas përkatësisë që përcaktohet në neni 3 të këtij ligji.

3. Çdo anëtar që është shkarkuar apo liruar në mënyrë të ligjshme nga detyra, nuk ka të drejtë të rizgjidhet në këshillin drejtues.

Neni 5

Funksioni i ERT

1. Selia e ERT është në Tiranë.

2. ERT nxjerrë rregullat dhe procedurat e funksionimit të saj për të kryer detyrat sipas këtij ligji. Rregullat dhe procedurat e funksionimit botohen në “Fletoren Zyrtare”.

3. Këshilli i ERT i merr vendimet me shumicë votash. Secili anëtar, duke përfshirë edhe kryetarin, ka një votë. Asnjë vend bosh në këshillin drejtues të ERT nuk cenon të drejtën e anëtarëve që mbeten për të ushtruar të gjitha të drejtat e këshillit të ERT.

4. Kryetari i këshillit është drejtuesi ekzekutiv i ERT.

5. Këshilli i Ministrave cakton pagën e kryetarit dhe të anëtarëve të këshillit drejtues.

Neni 6

Struktura organizative

1. Këshilli i Entit Rregullator përcakton strukturën organizative, numrin e punonjësve dhe

pagat e tyre.

2. Këshilli përcakton rregullat dhe kriteret e punësimit të punonjësve të ERT në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 7

Financimi dhe buxheti i ERT

1. Burimet e financimit janë:

a) Fondi fillestar grant i akorduar për fillimin e kësaj veprimtarie nga Këshilli i Ministrave pas emërimit të anëtarëve të Këshillit Drejtues të ERT.

b) Tarifat e caktuara për përpunimin e aplikimeve dhe kërkesave të ndryshme sipas këtij ligji.

c) Pagesat për licencat e dhëna nga ERT.

2. Jo më vonë se tre muaj para fillimit të çdo viti fiskal, ERT harton një fond të shpenzimeve operative të parashikuara dhe ia paraqet për miratim Këshillit të Ministrave.

3. ERT mban llogari të plota dhe të sakta të shpenzimeve faktike në përputhje me legjislacionin shqiptar të kontabilitetit.

4. Të gjitha të ardhurat e tepërta mbi shpenzimet e ERT kalojnë në buxhetin e shtetit.

KREU III

RREGULLIMI I TELEKOMUNIKACIONEVE

Neni 8

Detyrat dhe të drejtat e ERT

ERT udhëhiqet në veprimtarinë e tij nga politika dhe strategjia e zhvillimit të telekomunikacioneve në Republikën e Shqipërisë. ERT ka këto detyra dhe të drejta:

1. Nxiti zhvillimin e telekomunikacioneve nëpërmjet zgjedhjes së operatorëve gjatë licencimit.

2. Nxiti konkurrencën ndërmjet operatorëve të telekomunikacioneve, duke u bazuar në parimet e transparencës, mosdiskriminimit dhe konkurrencës së ndershme.

3. Harton kushtet dhe kriteret e licencimit të operatorëve të telekomunikacioneve.

4. Licencon personat fizikë e juridikë që plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara.

5. Krijon kushte të përshtatshme për futjen e operatorëve të rinj në tregun e telekomunikacioneve.

6. Organizon bashkëveprimin e operatorëve për të siguruar një rrjet kombëtar telekomunikacionesh unik, të hapur dhe të integrueshëm në rrjetin ndërkombëtar.

7. Ndihmon operatorët në arritjen e marrëveshjeve të interkoneksionit dhe ndërhyr, në rast mosmarrëveshjes, për këto çështje.

8. Garanton sigurinë dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara nga operatori.

9. Rrit efektshmërinë e shërbimeve të ofruara nga operatorët, në përputhje me kushtet e licencave.

10. Kontrollon zbatimin e ligjit “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë” dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore që lidhen me të, si dhe denoncon shkeljet, sipas rastit, pranë organeve kompetente.

11. Harton planin e numeracionit telefonik kombëtar dhe siguron zbatimin e tij nga operatorët.

12. Mbron interesat e përdoruesve të rrjetit dhe të shërbimeve të telekomunikacioneve.

13. Verifikon homologimin e pajisjeve të importuara të telekomunikacioneve dhe homologon ato që prodhohen në vend.

14. Përpunon normat dhe standardet e telekomunikacioneve, në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare, si dhe bashkërendon punën me drejtorinë e standardeve dhe cilësisë lidhur me to.

15. Mbikëqyr pajtueshmërinë elektromagnetike për të gjitha pajisjet terminale të lidhura në rrjetin publik të telekomunikacioneve.

16. Përcakton dhe kontrollon zbatimin e procedurave të vendosjes së tarifave të përdorimit të shërbimeve të telekomunikacioneve, të ofruara nga operatorët publikë për shërbimet me konkurrencë të kufizuar.

17. ERT miraton tarifat e telekomunikacioneve dhe procedurat e vendosjes së tyre, sipas

rregullave të përcaktuara në këtë ligj.

18. Harton planin e radiofrekuencave për qëllime civile dhe cakton brezat e frekuencave për çdo përdorues civil, duke dhënë licencën përkatëse. Identifikon shkelësit dhe merr masa për mënjanimin e përdorimeve abuzive.

19. Dërgon në Këshillin e Ministrave raportin për veprimtarinë e saj vjetore.

20. Publikon informacione për zhvillimin e përgjithshëm të telekomunikacioneve në Shqipëri.

21. Harmonizon interesat e përdoruesve, shtetit, operatorëve publikë, investitorëve dhe aksionarëve në sektorin e telekomunikacioneve.

22. Vepron si arbitër në konfliktet ndërmjet operatorëve publikë dhe vendos për zgjidhjen e konflikteve ndërmjet tyre, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në këtë ligj.

23. Merr vendime të pavarura, pa ndërhyrje nga jashtë, duke përfshirë edhe ato qeveritare.

Neni 9

Llojet e licencave

Në sektorin e telekomunikacioneve, licencat klasifikohen:

1. Licenca për shërbimet me konkurrencë të kufizuar.
2. Licenca për shërbimet me konkurrencë të lirë.

Neni 10

Kushtet e marrjes së licencës

1. Në varësi nga lloji i licencës, çdo person fizik a juridik mund të kërkojë dhe të konsiderohet i aftë për licencë, nëse këshilli drejtues vendos që ai përmbush këto kushte:

- a) Zotëron aftësi profesionale;
- b) zotëron aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, për të cilën ka bërë kërkesë;
- c) zotëron përvojë të mjaftueshme në sektorin e telekomunikacioneve, për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca;
- d) zotëron cilësi personale si kredibilitet dhe seriozitet;
- e) ka një seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë dhe një përfaqësues, i cili është përgjegjës për të komunikuar me këshillin dhe organet e tjera shtetërore për çështjet që kanë të bëjnë me veprimtarinë e licencuara.

2. Licencat e veçanta për shërbimet me konkurrencë të kufizuar i akordohen për çdo shërbim personave juridikë, vendas a të huaj, fitues të garës së hapur ndërkombëtare, që plotësojnë kushtet e përcaktuara dhe që gjykohen të leverdishëm për vendin.

3. Licencat për shërbimet me konkurrencë të lirë i akordohen çdo personi fizik a juridik, vendas a të huaj, që plotëson kushtet e përcaktuara në këtë ligj.

4. Këshilli mund të kërkojë të dhëna dhe dëshmi që mbështetin kërkesën e kandidatit për licencë dhe mund të refuzojë dhënien e saj, në qoftë se kushtet e paraqitura nga kërkuesi janë në kundërshtim me pikat a, b, c dhe d të këtij neni, si dhe me sigurimin kombëtar.

Neni 11

Dhënia e licencave

1. Dhënia e licencave bëhet nga Këshilli Drejtues.

2. Këshilli, pas aplikimit të bërë në atë formë që ka caktuar ai vetë dhe pas pagesës së një tarife nga aplikanti, i jep licencën, e cila e autorizon një person, fizik a juridik të kualifikuar, të ofrojë për publikun, rrjetin, shërbimin apo pajisjen e telekomunikacioneve, në përputhje me kushtet e vendosura në licencë dhe me dispozitat ligjore që rregullojnë sektorin.

3. Këshilli ka të drejtë të modifikojë a të bëjë amendamente në licenca, duke i dhënë gjithmonë mundësi të licencuarit të shprehë mendimet e tij për këto ndryshime.

4. Licenca për ofrimin e shërbimeve të telekomunikacioneve jepet për një periudhë jo më shumë se 30 vjet.

5. ERT është i detyruar të përcaktojë frekuencën, fuqinë, vendndodhjen dhe zonën e mbulimit

për operatorët radiotelevizivë brenda 2 javëve pasi atyre u është dhënë licenca për transmetime radiotelevizive nga Këshilli Kombëtar i Radiotelevizionit.

Neni 12

Amendamentet dhe revokimi i licencave

1. Këshilli ka të drejtë të bëjë amendamente ose të revokojë një licencë të dhënë, në rast të dështimit të të licencuarit për të qenë në përputhje me kushtet e licencës apo për ndonjë shkak tjetër të arsyeshëm.

2. Këshilli përcakton procedurat që kanë të bëjnë me amendamentet dhe revokimin e licencave, të cilat përfshijnë lajmërimin në kohë të të licencuarit dhe dhënien e mundësisë atij për t'u përgjigjur para veprimit të këshillit.

Neni 13

Kufizimet, licencat dhe të licencuarit

1. Asnjë i licencuar nuk ka të drejtë, pa miratimin me shkrim nga Këshilli, të blejë apo të përvetësojë në një formë tjetër licencën e një të licencuari tjetër.

2. I licencuari nuk ka asnjë lloj të drejte të transferojë licencën ose sipërmarrjen e tij me anë të shitjes, hipotekimit, dhënies me qera, këmbimit apo ndonjë forme tjetër, pa miratimin paraprak me shkrim të Këshillit. Ky miratim me shkrim nuk duhet të refuzohet ose të vonohet pa arsye të motivuar nga ana e Këshillit.

3. Mbajtësi i licencës mundet, me përjashtim të rasteve kur është ndaluar shprehimisht në kushtet e licencës, të bëjë marrëveshje për ofrimin e rrjetit, shërbimeve a pajisjeve të telekomunikacioneve me:

- a) një operator tjetër të licencuar të telekomunikacioneve;
- b) një person fizik të licencuar për ofrimin e një shërbimi të caktuar (service provider);
- c) mbajtësin e një licence për ofrimin e shërbimeve me vlerë të shtuar të telekomunikacioneve.

4. Çdo marrëveshje, që ka të bëjë me transaksione të tipit të përshkruar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, është e pavlefshme pa miratimin e Këshillit.

KREU IV

TARIFAT

Neni 14

Procedurat dhe tarifat

1. ERT, nëpërmjet kuadrit të plotë të rregullave që do të miratojë 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, përcakton procedurat e vendosjes së tarifave që u ofrohen përdoruesve të shërbimeve të telekomunikacioneve (tarifat për përdoruesin) nga operatorët publikë.

2. Nëpërmjet parimeve që përcaktohen sipas pikës 1 të këtij neni, ERT:

- a) mbron përdoruesit nga çmimet monopol;
- b) i krijon mundësi të licencuarit të rikuperojë në mënyrë të arsyeshme shpenzimet e kryerjes së një shërbimi efektiv;
- c) nxit efektshmërinë, duke bërë të mundur rritjen e fitimit financiar të të licencuarit nëpërmjet rritjes së të ardhurave bruto nga reduktimi i humbjeve joteknike ose uljes së kostos së shërbimit, me kusht që i licencuari të përmbushë të gjitha kërkesat e licencës së tij;
- d) nxit efektshmërinë ekonomike të sektorit, duke dhënë informacione të sakta të çmimeve në lidhje me ofertë-kërkesën e operatorëve të ndryshëm;
- e) sipas projektit;
- f) pasqyron ndryshimet në kosto dhe në aspekte të tjera ndërmjet kategorive të konsumatorëve dhe llojeve të shërbimit, në varësi nga subvencionet që do të zbatohen;
- g) u jep mundësi të licencuarve të respektojnë ligjet për mbrojtjen e mjedisit.

Neni 15

Procedurat e vendosjes së tarifave

1. ERT përcakton metodologjinë për vendosjen e tarifave, duke u mbështetur në dispozitat e këtij ligji.

2. Brenda 30 ditëve nga data që mbajtësi i licencës ka dhënë gjithë informacionin për tarifën që kërkon ERT, ky i fundit njofton mbajtësin e licencës në rast se ai (ERT) nuk është dakord me llogaritjet e paraqitura, duke dhënë edhe sqarimet e nevojshme.

3. Asnjë tarifë për përdoruesin ose pjesë e saj, nuk mund të modifikohet më shumë se një herë brenda një viti financiar, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë lejohet nga ERT. Mbajtësi i licencës nuk duhet të ndryshojë tarifën për përdoruesit jashtë parimeve, metodave dhe procedurave të përcaktuara nga ERT.

KREU V

ZBATIMI I LIGJIT NGA ERT DHE I LICENCUARI

Neni 16

Kërkesa për zbatimin e ligjit

1. ERT ka të drejtë të nxjerrë një urdhër, kur i licencuari shkel ndonjë nga kushtet ose kërkesat e licencës a dispozitave të këtij ligji për të garantuar zbatimin e tij.

2. Këshilli duhet të njoftojë të licencuarin nëse vendos të nxjerrë një urdhër:

a) T'i bëjë të ditur se po përgatit nxjerrjen e një urdhri.

b) T'i bëjë të ditur kërkesën, me anën e së cilës urdhri kërkon të garantojë respektueshmërinë e ligjit, shkeljen që është vërejtur dhe arsye të tjera të nevojshme.

c) Të përcaktojë periudhën brenda të cilës i licencuari ka të drejtë të bëjë kundërshtimin e urdhrit. Kjo periudhë duhet të jetë jo më pak se 10 ditë nga dita e njoftimit.

3. Pasi të jenë respektuar të gjitha procedurat e mësipërme, këshilli në çdo kohë, pas kalimit të 10 ditëve, ka të drejtë të nxjerrë urdhrin, nëse:

a) këshilli gjykon se i licencuari, për të cilin del urdhri, ka shkelur një kusht a një kërkesë të caktuar;

b) nxjerrja e urdhrit është e dobishme për të shmangur një shkelje të mundshme të një kushti a kërkesë nga i licencuari.

4. Pas nxjerrjes së urdhrit këshilli:

a) i dërgon të licencuarit një kopje të urdhrit;

b) boton urdhrin në atë formë që e shihet të përshtatshme për të tërhequr vëmendjen e personave që mund të preken prej tij;

c) realizon zbatimin e urdhrit.

5. Këshilli i ERT është i detyruar që për çdo ankesë që bëhet për një të licencuar lidhur me shkeljet e këtij ligji ose të akteve nënligjore në zbatim të tij, të njoftojë të licencuarin dhe t'i lërë mundësi atij të përgjigjet me shkrim.

Neni 17

Ankim ndaj urdhrit

I licencuari, brenda 30 ditëve nga marrja e urdhrit, ka të drejtë të ankohet në gjykatën e apelit.

Neni 18

Standardet dhe kushtet teknike

Këshilli ERT harton, miraton e kërkon zbatimin e standardeve dhe kushteve teknike të rrjeteve e shërbimeve të telekomunikacioneve, duke u bazuar në normat dhe standardet ndërkombëtare.

KREU VI ADMINISTRIMI

Neni 19

Kuadri rregullator

1. Në zbatim të këtij ligji ERT harton rregulloret e nevojshme, gjen mënyrën e duhur për t'i bërë ato të njohura. Këto rregullore janë të detyrueshme për t'u zbatuar.

2. Në përfundim të çdo viti ERT paraqet në Qeveri një raport për punën e bërë në plotësimin e kuadrit të saj rregullator, si dhe në kryerjen e detyrave të tjera sipas ligjit.

Neni 20

Verifikimi

ERT verifikon fakte a çështje, të cilat ai i quan të nevojshme për të përcaktuar nëse një subjekt ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji ose për të ndihmuar në zbatimin sa më mirë të kuadrit rregullator.

Neni 21

Nxjerrja e akteve

Të gjitha aktet që nxjerr ERT në bazë dhe për zbatim të këtij ligji dhe të ligjit "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë", duhet:

- a) të jenë me shkrim;
- b) të respektohet procedura për miratimin e tyre, ku të përcaktohen anëtarët e këshillit drejtues të ERT (duke përfshirë edhe kryetarin), që kanë votuar për këtë akt, si dhe vota e secilit anëtar.

Neni 22

Informacioni

1. Pas përfundimit të çdo viti financiar ERT i paraqet Kuvendit Popullor dhe Qeverisë një raport vjetor të gjendjes ekonomiko-financiare, si dhe parashikimet për vitin pasardhës.

2. Në zbatim të këtij ligji dhe akteve të tjera të nxjerra nga këshilli i ERT, çdo i licencuar është i detyruar t'i paraqesë këshillit të ERT raporte, pasqyra financiare dhe informacione, që ky këshill i konsideron të nevojshme lidhur me drejtimin ekonomik dhe shfrytëzimin operativ të rrjetit të telekomunikacioneve dhe funksionimin efektiv të ERT.

Neni 23

Publikimi i akteve

Dokumentacioni i skeduar i ERT është i hapur për t'u inspektuar nga publiku gjatë një periudhe të caktuar brenda orarit zyrtar. Këto skeda do të përfshijnë dokumentacionin përkatës, i cili ruhet dhe indekskohet sipas udhëzimeve, procedurave dhe standardeve të ERT, me kusht që t'u nënshtrohet procedurave dhe standardeve për ruajtje sekreti që këshilli i ERT mund të caktojë.

Neni 25

Çdo dispozitë ligjore që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 26

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2007, datë 3.3.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

